



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. .... Prot.

Vlorë, më .11.2016

**Vendim**  
**Nr. 64, datë 14.11.2016**

**PËR ÇELJEN E PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E BORDIT TË  
ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të pikës **1** dhe **2** të nenit **48** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", "Përbërja dhe krijimi i Bordit të Administrimit", Senati akademik,

**VENDOSI:**

1. Çeljen e procedurave për krijimin e Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë: 3 (tre) anëtarë nga UV dhe 4 (katër) nga MAS.
2. Kjo procedurë të respektojë fazat dhe afatet e mëposhtme:
  - a) Njoftim i personelit akademik në funksion të vetëkandidimit për anëtarë të Bordit të Administrimit të bëhet në datat 14-15 nëntor 2016.
  - b) Njoftim i njësive bazë për të bërë propozime për anëtarë të Bordit të Administrimit të bëhet në datat 14-15 nëntor 2016.
  - c) Administrimi i kandidaturave do të bëhet nga Senati Akademik në datat 16-21 nëntor, ora 16. 00.
  - d) Votimi në Senat i kandidaturave bëhet në datë 23. 11. 2016, në mbledhjen e tij të radhës.
  - e) Emrat e 3 (tre) anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të institucionit, përcillen në MAS, më datë 24. 11. 2016.
  - f) Në vijim pritet urdhri i Ministres së Arsimit dhe Sportit konform kompetencave të saj të përcaktuara në ligj.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

---

3. Individët kandidojnë me shkrim dhe e dorëzojnë vetë kërkesën e tyre tek sekretaria teknike e Senatit. Kërkesa e tyre, përveç dëshirës për kandidim, pasqyron edhe të dhëna individuale si: emri, mbiemri, grada apo titulli (nëse ka) dhe njësia kryesore nga vjen. Edhe kandidaturat e propozuara nga njësitë bazë japin të dhënat e mësipërme dhe kërkesa e tyre dorëzohet në sekretarinë teknike të senatit nga përgjegjësi i departamentit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Zëvendësrektori, Përgjegjësat e njësive kryesore, njësive bazë, Kryesekretaritë, Kancelari, Drejtoria e Financës, Zyra e burimeve njerëzore dhe Sekretaria teknike e senatit.
5. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.